

FJALA E DEPUTETES SHPRESA MARNOJ

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë

Të dashur qytetarë,

Në komisionet parlamentare përgjatë dy javëve janë shqyrtuar gjerësisht projektligjet e paketës fiskalë dhe të buxhetit të vitit 2023, ashtu siç po diskutohen edhe gjatë ditë së djeshme, me debate, kërkesa, sugjerime dhe pikëpamje nga më të ndryshmet. Duke marrë parasysh faktin që ky buxhet është hartuar në kohërat më të vështira që po kalojmë, nën presionin e një luftime, e cila ka dhënë efekte negative në çdo aspekt, si financiar ashtu edhe shoqëror, në çdo vend të Europës, ashtu edhe në vendin tonë, duhet theksuar se prioritet i tij janë pikërisht sektorët që ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e qytetareve dhe, kryesisht, në mbrojtjen e shtresave më në nevojë, si dhe vazhdimin njëkohësisht të investimeve në fusha të ndryshme, gjithashtu, pa ndërprerë në asnjë moment rindërtimin.

Konkretisht, ajo çfarë vlen për t'u theksuar dhe për t'u përsëritur në mënyrë të vazhdueshme si një ndër masat mbrojtëse më të prekshme ndaj qytetarëve është mbulimi nga qeveria e rritjes së çmimit të energjisë elektrike për çdo konsumator dhe biznes të vogël si mbështetje buxhetore prej 12 miliard lekë, E fillova më këtë aspekt, sepse më të vërtete qytetarët shqiptarë e kanë të vështirë për ta kuptuar realisht mbrojtjen, sepse akoma nuk kanë paguar asnjë qindarkë shtese të çmimit të energjisë elektrike, ndërkohë që ai është shumëfishuar, dhe gjithë këtë barrë e përballon qeveria. Ndaj, ka ardhur momenti jo vetëm për ta kuptuar por edhe për ta marrë seriozisht kursimin e saj, si nga fasha e caktuar prej 800 kilovat, por edhe si ndërgjegjësim i të gjithëve.

Për të vijuar me mbështetjen në këtë drejtim, dua të them se është ulur edhe kostoja e ngrohjes alternative nëpërmjet përjashtimit nga TVSH-ja të druve të zjarrit dhe paletave në import dhe në tregun e brendshëm, gjë që prek direkt qytetarët e zonave që përdorin drutë për ngrohje dhe gatim.

Në mbështetje të shtresave më në nevojë për vitin 2023 në mënyrë të përmbledhur kemi:

Rritjen e nivelit të pagës minimalë nga 34.000 në 36.000 lekë, nga e cila përfitojnë rreth 100.000 të punësuar; rritja e pragut të patatueshëm nga 40.000 në 50.000 lekë, nga e cila do të përfitojnë rreth 70.000 të punësuar.

Rritja e pagave në arsim, si në arsimin parashkollor ashtu edhe në atë parauniversitar, në shëndetësi dhe në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri, administrimit të pyjeve, ujitjes dhe kullimit, si dhe zbatimi i paketës së rezistencës në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike, që rritët më 10% dhe 2-fishimin e ndihmës për nënat më 2 apo më shumë fëmijë, për të moshuarit mbi 65 vjeç pa pension social apo pleqërie, si edhe për personat më aftësi të kufizuara, ku në total përfitojnë rreth 220.000 individë në vit.

Një mbështetje e veçantë është për gratë e papuna më 3 apo më shumë fëmijë deri në 18 vjeç, dukë i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërorë dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në 5 vjeç, si dhe një garanci sovranë për mbështetjen e 1000 familjeve të reja për blerje banese për herë të parë, ku të paktën një anëtar punon në administratë në profesionet e infermierisë dhe atyre në fushën e sigurisë më një efekt në buxhet prej 1,5 miliardë lekë. Duke vijuar me pensionistët, të cilët do të përfitojnë bonusin e fundvitit më një kosto prej 3,5 miliardë lekësh, si dhe indeksimin e pensioneve me inflacionin me një kosto shtesë prej 8,3 miliardë lekë për vitin 2023.

Të gjitha këto masa janë ndërmarrë në fushat më prioritare siç janë: arsimi, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura digjitale dhe siguria kibernetike apo edhe fusha e mbrojtjes.

Duke marrë parasysh faktin që ky buxhet synon, mbi të gjitha, ruajtjen e një qëndrueshmërie ekonomike dhe financiare në kushtet e një sfide të jashtëzakonshme, si dhe konsolidimin fiskal të vazhdueshëm nëpërmjet paketës fiskale dhe politikave monetare të ndjekura, për të cilat unë nuk do të ndalem me detaje, pasi ministrat dhe relatorët kanë diskutuar më hollësisht, unë dua të theksoj rëndësinë që kanë shpenzimet publike apo investimet në infrastrukturë në një vend që vuan akoma pasojat e dy krizave të mëparshme. Nëse ka diçka, të cilën ju, kolegë të opozitës, nuk mund dhe nuk duhet ta mohoni është përpjekja e kësaj qeverie për të rindërtuar, apo rikonstruktuar çdo institucion apo infrastrukturë publike në të gjithë Shqipërinë, më gjithë periudhën e vështirë në të cilën jemi.

Unë mund të mjaftohem duke përmendur investimet që janë bërë në zonën time, në Kurbin e në Lezhë, dhe habitem me faktin sesi kolegët e opozitës nuk duan t'i shohin, jo se nuk i shohin, të cilat janë në proces, ose të përfunduara, kjo jo vetëm në kuadër të rindërtimit, duke filluar më spitalin e ri bashkiak në Laç, që është investimi më i ri, me kushte bashkëkohore dhe pajisje moderne, si dhe me një staf të kompletuar, ku dua të theksoj së para pak ditësh në ambientet e këtij spitali u realizua lindja e parë pas

shumë vitesh që nuk ndodhte. Ky është përfitimi direkt i qytetarëve afër vendbanimit në zona të vogla si rezultat i investimeve publike.

Për të vazhduar më shëndetësinë, përsëri në Kurbin. Janë në proces rikonstruksioni dhe rindërtimi 3 qendra shëndetësore Laç, QSH Mamurras dhe Fushë-Kuqe, si dhe 2 ambulanca, Sanxhak dhe GJORËM, të cilat ose kanë filluar, ose pritet të fillojnë së shpejti.

Në lidhje më arsimin janë 6 shkolla dhe kopshte të rindërtuara, 9 shkolla dhe kopshte në proces rikonstruksioni apo të përfunduara. Të gjitha këto investime janë pas tërmetit.

Kemi godinën e bashkisë së Laçit në përfundim, një godinë moderne, e cila shumë shpejt pritet të inaugurohet.

Ndërtimi i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të ujësjellësit të Laçit, i cili është në fazë prove.

Gjithashtu, në kuadër të rindërtimit, përveç 522 apartamenteve të financuara nga qeveria turke, dua të përmend edhe rindërtimin e 203 apartamenteve të tjera me infrastrukturë tokësore dhe nëntokësorë; rindërtimin e 426 banesave individuale, si dhe rindërtimin e 9 godinave pallate. Të gjitha këto janë investime të qeverisë shqiptare.

Për ta përfunduar dhe për të treguar rëndësinë e menaxhimit të financave publike në nivel vendor dhe për të vazhduar procesin e decentralizimit fiskal të njërive të vetëqeverisjes vendore, si fokus të këtij buxheti, dhe me rritje të transfertave të pakushtëzuara për të gjitha bashkitë, Bashkia e Kurbinut do të financojë më fondet e veta 5 segmente rrugore në njësitë administrative të saj, si dhe kanalin e ujerave të zeza në Milot. Të gjitha këto japin një model të qartë të një buxheti të menduar mirë, me kujdes dhe me qëllimin kryesor mbrojtjen e qytetarëve dhe shtresave më në nevojë, pa lënë mënjanë asnjëherë investimet publike. Ju faleminderit dhe ju ftoj të gjithëve ta miratojmë këtë buxhet!